



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
BIOLOGJI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____

VENDI _____

KOMUNA _____


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 3ff87a489d62

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrethë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevci	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrethët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	

- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!



PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR
TESTI
BIOLOGJI

1. Cila veçori e dallon sfungjerin e detit, i cili i takon botës së gjallë, nga sfungjeri i kuzhinës, i cili është pjesë e botës jo të gjallë?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- forma madhësia frymëmarrja ngjyrshmëria
2. Qeniet e gjalla ndryshojnë gjatë jetës. Në cilën fazë njeriu arrin pjekurinë seksuale?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- menjëherë pas lindjes në fëmijërinë e hershme gjatë pubertetit në pleqëri
3. Si quhet organi në kuadër të sistemit të organeve të tretjes te njeriu, funksioni i të cilit është të tretë ushqimin dhe përthithë ushqimin e tretur nga rezhdet e zorrëve?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ezofagu lukthi zorra qorre zorra e hollë
4. Çka duhet bërë hardhuca që të sigurojë energjinë për t'u rritur dhe zhvilluar?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- të zhveshë lëkurën të hajë merimanga të vrapojë me shpejtësi të heqë bishtin
5. Çfarë funksioni ka një pjesë e qelizës, e cila është paraqitur në foto?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- transportimin e substancave
- frymëmarrjen qelizore
- trashëgiminë e veçorive
- krijimin e ushqimit





6. Cilat organizma janë formuar në epokën e fundit gjeologjike?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- cianobakteret paraardhësit e njeriut dinozaurët peshqit

7. Çfarë bashkësie përbëjnë të gjithë ketrit e një pylli?
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- popullacionin koloni ekosistem biosferën

8. Ngjyros rrethin në fushën e duhur, ashtu që të lidhësh vendbanimet me përfaqësuesit e tyre.

	livadhi	pyjet halore	pellgu
çafka gri	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
bredhi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
zambaku i bardhë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

9. Cila pjesë e trupit kërkon higjienë të rregullt që t'i shmanget sëmundjes nga kariesi?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- flokët duart këmbët dhëmbët

10. Bimët dhe shtazët kanë ngjashmëri të shumta, por edhe dallime në ndërtimin dhe mënyrën e jetesës. Cili proces e veçon lulerradhiquen për dallim nga mollëkuqja?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- thithja e oksigjenit shumimi seksual
 tajitja shfrytëzimi i dioksid karbonit





11. Përveç sistemit endokrin dhe muskolor dhe cili sistem i organeve është i domosdoshëm që të realizohet refleksi? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- cirkulator ashtëror reprodaktiv nervor

12. Të ushqyerit e shëndetshëm dhe kombinimi i artikujve ushqimorë janë baza e shëndetit. Nëse pohimi është i saktë, ngjyros rrethin në kolonën E SAKTË, ndërsa nëse pohimi është i pasaktë ngjyros rrethin në kolonën E PASAKTË.

	E SAKTË	E PASAKTË
1. Obeziteti në disa raste është pasojë e e kombinimeve jo të mira të artikujve ushqimor.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
2. Pemët, perimet dhe drithërat janë më të përfaqësuara në ushqimin e shëndetshëm.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
3. Çdo racion ushqimor duhet të përmbajë sasi më të madhe të yndyrës.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
4. Buka dhe patatja janë kombinim i shëndetshëm i artikujve.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

13. Si quhen të gjitha proceset e krijimit dhe zbërthimit, të cilat zhvillohen në prani të enzimeve?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- kibernacion metabolizëm termorregullim transpiracion

14. Si quhet ruajtja e gjendjes stabile në organizëm pamvarësisht ndryshimeve të mjedisit të jashtëm?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- sinapsë homeostazë transpiracion fotosintezë

15. Cili faktor ekologjik ka ndikim më të madh në formimin e formës së jastëkut te bimët?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- temperatura e lartë era e fuqishme
 frytshmëria e lartë e tokës sasia e madhe e të reshurave





16. Të gjitha dhelprat e një pylli dhe të gjithë zambakët e bardhë të një livadhi kanë diçka të përbashkët. Çka është e përbashkët e tyre?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Kanë rolin e njëjtë në zinxhirin ushqimor.
 Edhe njëri edhe tjetri paraqesin populacionin.
- Jetojnë në vendbanimet me nishë të ngjashme ekologjike.
 I takojnë të njëjtës biocenozë.

17. Ngjyros rrethët nën veçoritë me të cilat dallohen lulevjollca dhe koralit.

Lëvizja aktive	Mënyra e të ushqyerit	Iritimi	Ndërtimi i qelizës	Thithin oksigjen
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

18. Cili tip i sistemit nervor në evolucion është paraqitur i fundit?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ganglional
 nyjor
 shkallëzor
 gypor

19. Cilët janë dy organet shqisore te njeriu që janë të lidhur anatomikisht përmes pjesës ashtërore që e quajmë kërmill?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- shqisa për ftohje dhe nxehtësi
 shqisa e dëgjueshmërisë dhe drejtëpeshimit
- shqisa e nuhatjes dhe shijes
 shqisa e prekjes dhe dhembjes

20. Zigoti i macës ka 38 kromozome. Nga sa kromozome do t'i kenë qelizat e krijuara pas ndarjes së parë të zigotës?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- 23
 19
 38
 76



FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
BIOLOGJI

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

